REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.7.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT

PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari, i mbështetur nga, Blerina Krasniqi (Udhëheqëse e ekipit), Veton Misiri dhe Muhamet Balaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 9

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 15

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 30

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 31

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 33


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Dëshirojmë të falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 23/11/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Pasqyrat Vjetore Financiare paraqesin *një pamje të drejtë dhe të vërtetë*, në të gjitha aspektet materiale.

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se mungesa e një qasje sistematike për të konfirmuar vlerën e pasurive jofinanciare nga ana e Ministrisë ka rezultuar në një pasiguri mbi vlerën neto të pasurive.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Theksimi i Çështjes i pasqyron dobësitë në kontrolle për ta konfirmuar vlerësimin dhe regjistrimin e saktë të pasurisë dhe shpalosjen e plotë të obligimeve.	Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Theksimin e Çështjes në 2015 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurisë (shih Nënkapitullin 1.2).
Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial kanë nevojë për përmirësim.	Ministri duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ (shih çështjet 3,4 dhe 5).
Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë subvencionet dhe transferet, prokurimin dhe pagat dhe mëditjet.	Ministri duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 6,7,8,9,10,13,14,15,16,17,18 dhe 20).

Përgjigja e Ministrit – auditimi 2015

Ministri i ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet si dhe është zotuar se do t'i implementojë rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vertetë në të gjitha aspektet materiale, të pranimieve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare MF nr.03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, pergjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se mungesa e një qasje sistematike për të konfirmuar vlerën e pasurive jofinanciare nga ana e Ministrisë ka rezultuar në një pasiguri mbi vlerën neto të pasurive. Kjo ka ndodhur sepse Ministria nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për regjistrimin e gjithë pasurisë së saj, nuk ishte bërë inventarizimi sipas rregullave duke i përfshirë edhe qendrat rajonale dhe përshtatja me regjistrat e pasurisë të Ministrisë. Opinioni jonë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ai ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant për përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e

entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PFV

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 23/11/2015, është identifikuar një rrezik domethënës për PVF-të. Ky është rrezik i keqdeklarimit material që ka të bëj me evidencat jo të sakta rreth pasurive dhe mund të rezultojnë në theksim të çështjes. Rreziku është materializuar sepse nuk janë ndërmarrë veprime efikase nga menaxhmenti për ta adresuar çështjen në fjalë.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

MPMS kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore; dhe
- Kërkesat në lidhje me planifikimin e prokurimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur. Çështjet e ngritura në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 15/12/2015, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

DEKLARATA E BËRË NGA ZKA dhe ZKF

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë pasi që gjatë auditimit (me përjashtim të çështjes së pasurive) nuk janë identifikuar gabime materiale dhe çështje tjera.

Rekomandimet

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë** - Ministri duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për ta siguruar vlerësimin dhe regjistrimin e plotë dhe të saktë të gjithë pasurive jokapitale dhe shpalosjen e drejtë të detyrimeve.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MPMS që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MPMS veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga MPMS, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi

ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi i auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë janë të vendosura.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të MPMS ka rezultuar në 20 rekomandime kryesore. MPMS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 6 rekomandime janë implementuar; 11 janë adresuar por nuk janë implementuar plotësisht dhe 3 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 –Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar sepse MPMS nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të AP-ës.

Rreziku Mos implementimi i plotë i reomandimeve të AP ka ndikuar që të përsëriten dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve në sistemet financiare kyçe, duke rezultuar në:

- Praktika jo të mira të qeverisjes;
- Planifikim të dobët të buxhetit në fushën e subvencioneve dhe investimeve kapitale;
- Mangësi në procesin e menaxhimit të skemave pensionale dhe sociale; dhe
- Mangësi në menaxhimin e personelit.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë që është rishikuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Progresi i implementimit të rekomandimeve të AP duhet të monitorohet në baza të rregullta tremujore.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MPMS më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Gjatë vitit 2015 nuk ishin vendosur procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut. Megjithatë pas diskutimeve tona me menxhmentin, menjëherë janë ndërmarrë masat dhe është hartuar rexhistri i rreziqeve.

2. strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) konsiderohet si e vendosur nga MPMS, megjithëse ajo nuk është e miratuar nga qeveria dhe si e tillë nuk ka mundur të gjej zbatim nga ana e Ministrisë;

3. Nuk kishte një lidhje të përafërt në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit, pasi që vlera e kontratave të planifikuara tejkalonte në mënyrë të theksuar mundësitë dhe parashikimet buxhetore të MPMS;

4. Përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohet si i vendosur nga MPMS dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion.

Veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetvlerësimi i vitit 2014 është i limituar. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda MPMS-së për rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku

Mos identifikimi i çështjeve të rëndësishme të qeverisjes pamundëson adresimin e tyre me kohë si dhe rrezikon humbjen e mundësive për zhvillim.

Rekomandimi 4

Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim i procesit për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MPMS operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies

MPMS ka nën menaxhimin e saj 7 qendra rajonale të Departamentit të Administratës Pensionale, 7 Qendra rajonale të punësimit dhe 8 Qendra për aftësim profesional. Raportimi financiar dhe operativ bëhet përmes Departamenteve përkatëse. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportim me kohë.

Çështja 4 - Proceset e llogaridhënies – Prioriteti i lartë

E gjetura Rishikimi ynë ka nxjerrë në pah një nivel të dobët të raportimit dhe llogaridhënies ndërmjet zyrave/qendrave lokale dhe departamenteve të Ministrisë. Poashtu, kemi vërejtur nivel të ulët të bashkëpunimit dhe komunikimit për shkëmbimin e informatave ndërmjet MPMS dhe Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Bashkëpunimi ishte i ulët gjatë nëntë muajve të parë të vitit, përkundër faktit se janë nënshkruar memorandumet e mirëkuptimit ndërmjet këtyre institucioneve, me qëllim të pastrimit të listave të pensioneve dhe përfituesve të ndihmave sociale. Derisa në muajt e fundit të vitit ky bashkëpunim është përmirësuar dukshëm.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së ulët e kanë reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar brenda MPMS. Kjo rezulton në dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit ndaj departamenteve dhe qendrave rajonale, për të siguruar bashkëpunim dhe raportim më të efektshëm nga qendrat rajonale. Poashtu duhet të rishikohet bashkëpunimi me ARC dhe ATK në mënyrë që vihet në pah përfitimi nga marrëveshjet e arritura. Kjo do të ndikoj në rregullsinë e pagesave për skemat pensionale dhe sociale dhe në kursimin e buxhetit.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në Kontrollet Menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura	Edhe pse procesi i raportimit në Ministri është javor dhe i rregullt, raportet përveç që nuk janë gjithëpërfshirëse, ato nuk shqyrtohen dhe konsiderohen nga menaxhmenti i lartë në mënyrë që të sigurohet llogaridhënie efektive. Raportet nuk përmbajnë nivel të informatave që do të mundësonin menaxhim efektiv të aktiviteteve për shkak se nuk ekziston ndonjë raportim standard.
Rreziku	Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet në mënyrë pro aktive si dhe ul efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo e zvogëlon aftësinë për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë.
Rekomandimi 6	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim i formës aktuale të e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, dhe të sigurojë se raportimi i departamenteve të standardizohet dhe plotësohet me informatat e nevojshme, për të mbështetur një menaxhim më efektiv të veprimtarisë .

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MPMS dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë. Këshillat tona në lidhje me komitetin e auditimit të cilat i kemi dhënë në memon e përkohshme të auditimit janë marrë parasysh nga Ministria dhe kanë filluar të japin efektin e tyre.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket MPMS, menaxhimi i subvencioneve dhe transfereve mbetet shqetësim. Kjo për shkak të skemave të shumta pensionale dhe sociale, numrit të madh të përfituesve dhe buxhetit të limituar. Jo çdo herë rregulloret janë zbatuar me përpikëri, duke rezultuar në pagesa të parregullta dhe dëmtim të buxhetit. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar MPMS që mos të pësojë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv. Përveç skemave pensionale dhe sociale, fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, menaxhimi i pasurisë dhe respektimi i rregulloreve për paga dhe mëditje dhe prokurim.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MPMS, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**309,651,628**	**315,627,614**	**315,278,581**	**283,792,987**	**228,729,335**
Granti i Qeverisë -Buxheti	309,651,628	315,561,163	315,275,283	283,697,987	283,729,335
Donacionet e jashtme	-	66,451	3,298	95,000	-

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 5,975,986€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe me vendime të Qeverisë në vlerë 5,909,535€, si dhe donacioneve të jashtme në vlerë 66,451€.

Në vitin 2015, MPMS ka përdorur 99.8% të buxhet final ose 315,278,581€, ngjashëm krahasuar me vitin 2014.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**309,651,628**	**315,627,614**	**315,278,581**	**283,792,987**	**228,729,619**
Pagat dhe Mëditjet	5,154,220	5,104,701	5,104,701	4,748,298	4,096,241
Mallrat dhe Shërbimet	2,468,892	2,419,146	2,304,590	2,460,819	2,633,961
Shërbimet komunale	407,085	415,183	379,254	381,976	399,629
Subvencionet dhe Transferet	299,262,431	305,917,004	305,718,653	274,727,733	219,427,510
Investimet Kapitale	2,359,000	1,771,580	1,771,383	1,474,160	2,172,079

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje për 49,519€ është rezultat i zvogëlimit me rishikim të buxhetit në vlerë 103,849 dhe pastaj rritjes me vendime të qeverisë në vlerë 53,330€; Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%;
- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve ishte më i vogël se sa buxheti final për 49,746€. Ky ndryshim është rezultat i zvogëlimit me rishikim dhe me vendime të Qeverisë. Te kjo kategori e shpenzimeve në fund të vitit kishte një suficit prej 114,556€, ndërsa obligimet e papaguara ishin 76,604€;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte më i lartë për 6,654,573€, krahasuar me atë fillestar, dhe ishte shpenzuar afër 100%. Ndryshimet në buxhetin final kishin ardhur fillimisht si rezultat i zvogëlimit me rishikim në vlerë 2,000,000€, pastaj rritjes me disa vendime të qeverisë në vlerë 8,970,083€ për mbulimin e skemave pensionale të reja dhe atyre ekzistuese dhe në fund kishte një shkurtim në vlerë 315,510€ me vendim të qeverisë.
- Buxheti final i Investimeve kapitale ishte më i ulët për 587,420€. Fillimisht kishte një rritje me rishikim në vlerë 50,000€. Pastaj me vendim të qeverisë kishte shkurtime në këtë kategori në vlerë 377,420€. Edhe pse buxheti final në këtë kategori ishte shpenzuar afër 100%, buxheti fillestar ishte shkurtuar për shkak të dinamikës së ulët të shpenzimeve.

Çështja 6 – Planifikimi dhe realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura	Pavarësisht ekzekutimit 100%, planifikimi i buxhetit len vend për përmirësim, sidomos tek subvencionet dhe transferet dhe investimet kapitale. Për këtë nevojitet dialog më i thellë me Ministrinë e Financave dhe në nivel të qeverisë gjatë aprovimit të buxhetit si dhe vlerësim më i detajuar i kërkesave buxhetore të paraqitura nga MPMS-ja. Tek kategoria e investimeve kapitale, përveç zvogëlimit të buxhetit final edhe dinamika e ekzekutimit të buxhetit nuk ishte në harmoni me rrjedhën e planifikuar të parasë pasi që, 90% e buxhetit është shpenzuar në tremujorin e fundit të vitit.
Rreziku	Planifikimi jo i mirë i buxhetit vë në vështirësi arritjen e objektivave të Ministrisë dhe shkakton pakënaqësi tek shfrytëzuesit e shërbimeve. Derisa realizimi i shpenzimeve kapitale në pjesën e fundit të vitit mund të ndikojë që pagesat të procesohen potencialisht pa kontrolle adekuate dhe të rezultojnë në parregullsi eventuale.
Rekomandimi 7	Ministri duhet të sigurojë që të thellohet dialogu me Ministrinë e Financave rreth planifikimit të buxhetit me theks të veçantë tek skemat sociale dhe pensionale në mënyrë që të evitohen vështirësitë e vazhdueshme në realizimin e obligimeve ligjore dhe të synimeve paraprakisht të caktuara.

3.4 Prokurimi

MPMS bazuar në planin vjetor të prokurimit kishte zhvilluar procedura të prokurimit dhe kishte nënshkruar kontrata me vlerë të përgjithshme rreth 535,676€. Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Çështja 7 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i mesëm

E gjetura

Nga shqyrtimi i 11 kontratave ne kemi identifikuar një sërë dobësish të përbashkëta, të cilat kanë pasur ndikim mbi secilën kontratë të rishikuar. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet e mëposhtme:

- Në dy raste ishin shpërblyer me kontratë OE në mungesë të dëshmive për kapacitetin teknik e profesional të përcaktuar me dosje të tenderit, siç ishte lista e projekteve të realizuar tri vitet e fundit (me referenca) dhe katalogu me fotografi/specifikacion detal për produktet e ofruara . Këto kontrata ishin: "Renovimi i pjesëshëm i APK Gjakovë" në vlerë 8,959€ dhe "Furnizim me pajisje të TI" në vlerë 7,850€.

Rreziku

Shpërblimi me kontratë i OE-ve në mungesë të sigurisë së mjaftueshme për kapacitetet e tyre teknike dhe profesionale mund të rezultojë në vështirësi të caktuara gjatë realizimit të kontratave, në realizimin e tyre nën standardin e duhurapo edhe vlerë e dobët për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi 8

Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse në rastet e identifikuara kërkesat e prokurimit nuk janë respektuar në terësi si dhe të ndërmarr veprime për adresimin dhe parandalimin e tyre në të ardhmen.

Çështja 8 – Dobësitë jo-sistematike të prokurimit – Prioritet i lartë

E gjetura Nga rishikimi i 11 kontratave, kemi identifikuar se disa kontrolle menaxheriale ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë dhe kjo ka rezultuar si më poshtë:

- Tek kontrata "Mirëmbajtja, servisimi, furnizimi me pjesë rezervë i aparateve fotokopjuese" në vlerë prej 40,656€, vlera e sigurisë së ekzekutimit ishte 1,000€, ndërsa duhej të ishte 4,066€, që është 10% e shumës së kontratës.

Rreziku Aplikimi i shumës më të vogël të sigurisë së ekzekutimit se sa kërkohet me rregullat e prokurimit dhe me dosjen e tenderit mund të rezultojë me vonesa në furnizim apo mospërpmbushje të kushteve të kontratës.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë se do të merren masa për të siguruar se në të gjitha rastet kur kërkohet siguria e ekzekutimit, vlerat të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avancet, Komunalitë, etj

Shpenzimet të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit kanë të bëjnë me shpenzimet komunale, shpenzimet e udhëtimit, përfaqësimit etj.

Çështja 9 – Menaxhimi jo i duhur i avanseve për udhëtime zyrtare– Prioritet i lartë

E gjetura Vlera e avanseve të pambyllura në PVF ishte 10,921€ dhe kishte të bënte me kredit kartelat të cilat nuk janë arsyetuar me dëshmitë përkatëse;

Në pesë raste janë paguar avanse për udhëtime zyrtare në vlerë prej 1,433€, ndërsa në dosjen e pagesës mungonin ftesat dhe agjendat për këto udhëtime.

Këto situata kishin ndodhur në mungesë të kontrolleve efektive të mbikëqyrjes dhe aprovimit.

Rreziku Mungesa e dokumenteve të nevojshme që arsyetojnë shpenzimet e realizimit të udhëtimeve zyrtare si dhe mos arsyetimi i kredit kartelave mund të rezultojë në shpenzime të paarsyeshme dhe të parregullta.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese në lidhje me pagesat në avans dhe të vendos kontrolle për të siguruar mbylljen e tyre me kohë, të shoqëruara me dokumentacionin adekuat për të mbështetur validitetin.

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollet që operojnë në nivel të Ministrisë kanë të bëjnë me: autorizimin e listës së pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme; rishikimin e buxhetit për këtë kategori barazimet me Thesarin etj.

Ne kemi testuar mostra të pagave nga Departmenti i Administratës Qëndrore, dhe nga Qendrat përkatëse rajonale nën administrimin e Ministrisë për të verifikuar nëse ekziston pajtueshmëri midis listës së pagave me sistemin e Payrollit, procedurat e rekrutimit dhe rregullsinë e dosjeve të personelit.

Çështja 10 – Rekrutime dhe kontrata të parregullta të punëtorëve – Prioritet i lartë

E gjetura

Ishin angazhuar njëmbëdhjetë persona me kontrata për shërbime të veçanta pa aplikuar procedura të rekrutimit,.

Në tri raste kandidatët e përzgjedhur nuk i plotësonin të gjitha kriteret e konkursit që kishin të bënin me kualifikimin profesional dhe përvojën e punës.

Në dy raste të rekrutimit për pozitat: Zyrtar për informim dhe Asistente administrative, nuk ishin nënshkruar dokumentet e nevojshme adminstrative nga anëtarët e komisionit rekrutues.

Në një rast, punonjësja ishte e pajisur me akt emërim edhe pse nuk mbante pozitë të shërbimit civil në MPMS.

Të gjeturat e shpalosura më lartë kanë ndodhur sepse nuk ishin aplikuar rregulloret e jashtme me konisistencë.

Rreziku

Mos aplikimi i të gjitha kërkesave të konkursit mund të rezultojë me rekrutimin e stafit jo më të mirë të mundshëm dhe kjo të ndikoj në punët e përditshme të ministrisë. derisa angazhimi me akt emërime për pozitat që nuk i takojnë shërbimit civil mund të rezultojë me obligime eventuale për Ministrinë.

Rekomandimi 11

Ministri duhet të shqyrtojë rastet e identifikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimeve të aplikohen kërkesat e konkursit për të mundësuar punësimit a kandidatëve më meritor. Derisa kontratat e punës duhet ti përshtaten pozitave përkatëse.

Çështja 11 - Transfer i parregullt i stafit në një organizatë tjetër buxhetore – Prioritet i mesëm

E gjetura Në një rast, transferi i punëtorit në një organizatë tjetër buxhetore kishte ndodhur një ditë pasi që personi ishte pranuar në vendin e punës si Zyrtar për Integrime Evropiane në MPMS. Kjo është bërë pa u arritur kohën minimale të qëndrimit të punëtorit në pozitën e rekrutuar.

Rreziku Transferimi i stafit menjëherë pas rekrutimit e bënë rekrutimin joefektiv dhe kjo shkakton përsëritje të konkursit dhe kosto shtesë për plotësimin e pozitës së njëjtë.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të sigurojë një plan më të qëndrueshëm dhe më mirë të menduar të rekrutimit para fillimit të procedurave për realizimin e tij për të evituar punësimet joadekuate dhe kostot financiare dhe administrative nga përsëritja e proceseve.

Çështja 12 - Ushtrues detyre më gjatë se tre muaj- Prioriteti i mesëm

E gjetura Sipas Ligjit për shërbimin civil ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre muaj. Ne kemi vërejtur se gjatë vitit 2015 në dy raste të ushtrimit të pozitave drejtuese është tejkaluar afati. Kjo pasi që menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprimet me kohë për inicim të procedurave për plotësimin e këtyre pozitave të lira.

Rreziku Mbulimi i pozitave kyçe nga ushtrues detyre më gjatë se tre muaj mund të rezultojë në performacë të dobët operacionale dhe mosarritje të objektivave.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurojë se janë respektuar afatet ligjore në rastet e ushtrimit të pozitave të caktuara dhe që me kohë janë marrë të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pozitave të lira.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Rreth 97% e shpenzimeve të përgjithshme të MPMS i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Këto kanë të bëjnë me skemat pensionale dhe sociale, pensionet e parakohshme, subvencionet për përfitues individual dhe publikë, etj. Menaxhimi i skemave pensionale vazhdon të mbetet sfidë për Ministrinë pavarësisht përpjekjeve për përmirësimin e menaxhimit të tyre. Ministria gjatë vitit ka arritur marrëveshje me disa institucione për shkëmbim informatash rreth përfituesve të skemave sociale dhe atyre pensionale, megjithatë auditimi ynë ka venë në pah dobësitë si më poshtë.

Çështja 13 –Pagesa e pensioneve për personat e vdekur - Prioritet i lartë

E gjetura

Nga krahasimi i të dhënave/regjistrave ndërmjet MPMS dhe ARC-së, kemi konstatuar se ekzistojnë raste të dhënies së pensioneve për persona të vdekur. Sipas rregullave, pensionet duhet të ndalen pas vdekjes së përfituesit..

Totali i pensioneve të paguara pas vdekjes së përfituesve arrinë vlerën prej 801,723€. Prej tyre, 199,194€ janë paguar në 2015 për përfituesit që kishin vdekur në 2014 e më herët. Në mesin e këtyre pagesave, kishte raste kur pensionet ishin paguar deri në 11 muaj pas vdekjes së përfituesve. Për më shumë rreth numrit të pagesave mujore dhe vlerës së paguar referohuni tabelës së mëposhtme.

Lista e pensioneve të vazhduara pas vdekjes së përfitueseve

Lloji i pensionit (skemës pensionale)	**Pagesat për rastet e ndodhura para vitit 2015**		**Pagesat për rastet e ndodhura gjatë vitit 2015**		**Gjithsej Gabimi financiar 2015**	
	Numri i pagesave	**Shuma (€)**	**Numri i pagesave**	**Shuma (€)**	**Numri i pagesave**	**Shuma (€)**
	a	*b*	*c*	*d*	*(a + c)*	*(b + d)*
Pensionet Kontributive (PK) neto (pas kthimit).	46	6,580	1,374	198,395	1,420	204,975
Pensionet për personat me aftësi te Kufizuara (PPAK).	1,870	140,925	1,024	82,800	2,894	223,725
Pensionet për Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK).	8	2,586	12	3,389	20	5,975
Pensionet Bazë (PB) **neto (pas kthimit)**	62	12,630	3,242	252,125	3,304	264,755
Pensionet për të verbërit (PV)	193	24,885	151	19,500	344	44,385
Pensionet e Trepçës (PT)	26	2,280	72	7,525	98	9,805
Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)	5	895	18	592	23	1,487

Pensionet e Asistencës Sociale (neto)	16	1,185	85	6,944	101	8,129
Pensionet e DFDIL	28	7,228	143	31,260	171	38,488
Gjithsej	**2,254**	**199,194**	**6,121**	**602,530**	**8,375**	**801,723**

Rreziku Mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave të pensioneve, rezulton me pagesa të parregullta, dhe me dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 14 Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet e duhura në mënyrë që të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në pastrimin e listave, duke bërë krahasimin e vazhdueshëm sistematik të regjistrave me regjistrin civil, në baza mujore, para se të bëhet kompenzimi i pensioneve. Poashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë.

Çështja 14 –Përfitime të pensioneve nga persona të punësuar- Prioritet i lartë

E gjetura Nga krahasimi i regjistrave ndërmjet MPMS-së dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), kemi konstatuar se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve nga persona të cilët realizojnë të ardhura personale. Kjo ka ndodhur gjatë nëntë muajve të parë të vitit, derisa pas shtatorit 2015, gjendja lidhur me ndihmat sociale ka ndryshuar dukshëm, pasi që MPMS ka filluar bashkëpunimin për krahasimin e shënimeve me ATK-në.

Lloji i skemës pensionale	**Numri i pagesave**	**Gabimi Financiar (€)**
Pensionet e Trepçës	1,546	193,680
Pensionet e Ndihmave	684	53,530
Gjithsej	**2,230**	**247,210**

Rreziku Përfitimi i ndihmës sociale nga persona të punësuar është në kundërshtim me ligjin dhe shkakton pagesa të parregullta dhe dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 15 Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprimet e duhura për të siguruar forcimin e kontrolleve të brendshme në pastrimin e listave të pensioneve nga personat e punësuar, duke bërë krahasimet sistematike të shënimeve me ATK, para ekzekutimit të pagesave. Poashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë.

Çështja 15 – Përfituesit e dyfishtë të skemave pensionale- Prioritet i lartë

E gjetura Nga krahasimi i shënimeve ndërmjet skemave pensionale brenda ministrisë, kemi gjetur raste ku persona të njëjtë ishin përfitues në më shumë se në një skemë pensionale. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së komunikimit ndërmjet data bazave të brendshme të ministrisë dhe mungesës së një softueri të integruar që përfshin të gjitha skemat pensionale. Në tabelën në vijim janë paraqitur rastet e tilla sipas kategorive pensionale.

Përfituesit e dyfishtë të skemave pensionale		
Përfituesit sipas llojit të skemës pensionale	**Numri i pagesave**	**Gabimi Financiar (€)**
Pensionistët e verbër përfitues edhe të pensionit bazë (PB)	518	110,025
Pensionistët e verbër përfitues edhe të pensionit kontributiv (PK)	244	61,700
Pensionistët e verbër përfitues edhe në pensionin e veteranëve të luftës	201	34,700
Pensionistët e verbër përfitues edhe në pensionin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK-së)	2	510
DFDIL përfitues në skemën e pensioneve për personat me aftësi te kufizuar (PPAK)	34	11,550
Kthimi i mjeteve	(515)	(63,775)
Veteranët e luftës përfitues të ndihmave sociale (NS)	2	510
Veteranët e luftës përfitues të pensioneve të PPAK-së	5	850
Veteranët e luftës përfitues të pensioneve të TMK-së	1	510
Veteranët e luftës përfitues të PB	3	510
DFDIL përfitues në skemën e TMK-së	202	60,502
DFDIL përfitues në skemën e PPAK-së	15	3,281
DFDIL përfitues ne skemën e ndihmave sociale	4	600
DFDIL përfitues ne skemën FSK-së	29	8,372
DFDIL përfitues ne skemën PK-së	608	145,222
NS përfitues ne skemën e të verbërve	25	1,760
NS përfitues ne skemën e PK-së	13	765
NS përfitues ne skemën e Trepçës	112	7,840
Trepça përfitues në skemën e TMK-së	27	5,250

Trepça përfitues ne skemën e të verbërve	15	1,575
Trepça përfitues në skemën DFDIL-së	40	4,200
Trepça përfitues në skemën PPAK-së	22	2,310
Trepça përfitues në skemën PB	10	1,260
Trepça përfitues në skemën PK	9	1,470
Gjithsej	**1,626**	**401,497**

Rreziku Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë, janë në kundërshtim me ligjin, dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi 16 Ministri duhet të sigurojë se do të vazhdoj forcimin e kontrolleve të brendshme duke krijuar sistem më efektiv të komunikimit të databazave ndërmjet skemave pensionale. Të shikohen mundësitë për krijim të një softueri të integruar të të gjitha skemave pensionale, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përfitimeve të dyfishta të pensioneve. Poashtu duhet të merren të masat ligjore në mënyrë që përfituesit ti kthejnë mjetet e përfituara jashtligjshëm në buxhetin e ministrisë.

Çështja 16 Mungesë e qartësisë në lidhje me pagesën e pensioneve të veteranëve – Prioriteti i lartë

E gjetura Me ligjin 04/L-261 për veteranët e luftës së UÇK-së përcaktohet kompenzimi për këtë kategori në vlerë 170€ për muaj. Nga muaji shtator 2015, MPMS kishte kryer pagesa në vlerë prej 5,413,190€. Ne kemi vërejtur qe për disa veteran pensionet janë paguar në mënyrë retroaktive dhe për 6,474 veteranë të tjerë jo. Në këtë ka ndikuar mos qartësimi i ligjit përkatës i cili nuk e specifikon nëse duhet apo jo të paguhen pensionet në mënyrë retroaktive. Diferenca ndërmjet shumës së paguar dhe asaj që do të duhej të paguhet (në rast se për të gjithë do të vlente pagesa në mënyrë retroaktive) ishte 1,394,824€. Hezitimi për të mos i paguar këto pensione në mënyrë retroaktive, ndër të tjera ka ardhur edhe si rezultat i mungesës së buxhetit pas shkurtimeve buxhetore nga ana e qeverisë.

Rreziku Mungesa e qartësisë në lidhje me pagesat për pensionet e veteranëve, ka ndikuar që ata të mos trajtohen në mënyrë të barabartë. Kjo poashtu mund të shkaktojë pakënaqësi tek përfituesit dhe mund të ndikoj në arritjen e objektivave të ministrisë.

Rekomandimi 17 Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerren veprime të nevojshme për qartësimin e bazës ligjore në mënyrë që të sigurohet se të gjithë veteranët do të trajtohen në mënyrë të barabartë. Në rast se me ligj apo marrëveshje me veteranët është vendosur që pensionet të paguhen në mënyrë retroaktive, atëherë duhet të bëhet pagesa për të gjithë ata që nuk i kanë marrë këto pensione. Në te kundërtën nëse ato pensione që janë paguar retroaktivisht nuk kanë qenë të rregullta, atëherë duhet të shqyrtohet mundësia që mjetet e paguara tepër t'u ndalen përfituesve në pagesat pasuese.

Çështja 17 – Çështje tjera lidhur me subvencionet dhe transferet – Prioriteti i lartë

E gjetura Nga subvencionet dhe transferet ishte paguar komisioni për të burgosurit politik në vlerë prej 15,900€, ndërsa pagesa të tilla do duhej të ekzekutoheshin nga mallrat dhe shërbimet. Më tej, përfituesve nuk i është ndalur tatimi në burim, sipas kërkesave të ligjit mbi të ardhurat personale.

Në dy raste të subvencionimit të përfituesve individual për shërim jashtë vendit, në vlerë prej 3,500€, mjetet e shpenzuara nuk ishin arsyetuar nga ana e përfituesve sipas marrëveshjes.

Rreziku Pagesat e komisioneve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ndikon në keqklasifikimin e shpenzimeve në PVF. Mosarsyetimi i mjeteve të dhëna nga përfituesit nuk ofron siguri nëse atë mjete janë përdor për qëllimet për të cilat mjetet janë dhënë.

Rekomandimi 18 Ministri duhet të sigurojë që kompenzimet për shërbimet e ofruara nga të angazhuarit në komisione do të bëhen nga kategoria e mallrave shërbimeve, në përputhje me kërkesat ligjore. Poashtu, duhet të sigurohet monitorim i mirëfilltë dhe arsyetim adekuat i mjeteve të marra në formë të subvencionit nga ana e përfituesve individual.

3.6 Të Hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPMS në vitin 2015 ishin në vlerë 200,126€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga Autoriteti i Inspektoratit të Punës (AIP) dhe Departmenti për Punë dhe Punësim (DPP). Të hyrat e inkasuara derdhen në Buxhetin e Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga Ministria. Ne kemi testuar një numër të caktuar mostrash dhe nuk kemi ndonjë çështje të ngritur në lidhje me to.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Ministria kishte bërë përparime në regjistrimin e pasurisë. Megjithatë regjistri i pasurisë së saj nuk paraqet pasuritë totale, dhe si i tillë është jo i besueshëm. Kjo pasi që, blerje të këtij viti nuk ishin regjistruar në regjistrin e E-pasurisë dhe mungonte një proces adekuat për inventarizim në nivel të organizatës. Regjistri aktual i pasurisë kapitale në SIMFK i paraqitur në PVF tregon vlerën prej 19,637,832€, ndërsa pasuria jokapitale nën 1,000€ përmban shumën prej 637,132€. Vlera e stoqeve ishte 31,487€.

Çështja 18 – Menaxhim i dobët i pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura Ministria nuk i kishte evidentuar në regjistrin e-pasurisë, pasuritë e blera gjatë vitit 2015 në vlerë prej 169,545. Kjo kishte ndodhur për shkak të ndryshimeve në stafin përgjegjës nga ana e menaxhmentit.

Nuk ishte formuar komisioni për inventarizimin e pasurisë në nivel të organizatës, mirëpo për këtë punë ishin angazhuar komisione në nivel të zyreve regjionale, të cilët nuk kishin kryer punën në përputhje me kërkesat e UA 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare. Ndërlidhja e shënimeve mes këtyre raporteve dhe zyrtarit të pasurisë nuk ishte bërë. Si të tilla, shënimet e prezantuara në PVF lidhur me pasuritë janë të pasakta.

Rreziku Mungesa e kontrolleve në menaxhimin e pasurisë dhe mos regjistrimi i saj sipas rregullave mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin dhe përdorimin e paautorizuar të tyre. Mos regjistrimi i të gjitha pasurive ndikon në cilësinë e informatave të shpalosura në PVF.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të sigurojë që në të ardhmen, komisioni i inventarizimit të formohet në nivel të organizatës, dhe të kryejë punën sipas kërkesave ligjore në mënyrë që vlera e pasurive në PVF të jetë e plotë dhe e saktë. Duhet të shtohen aktivitete për përfshirjën e të gjitha pasurive në regjistrat kontabël dhe në e-pasuria.

Çështja 19 – Menaxhimi i automjeteve zyrtare - Prioritet i mesëm

E gjetura Në pesë raste kemi hasur në tejkalim të limiteve të lejuara të derivateve për automjetet private, pa vendim paraprak të miratuar nga përgjegjësit.

Në 40 raste nuk ishin raportuar shpenzimet e derivateve për veturat e Ministrisë.

Rreziku Tejkalimet e limiteve të lejuara të derivateve dhe mosraportimi i shpenzimeve të derivateve të automjeteve në baza mujore mund të rezultojë në shpenzime të paplanifikuara dhe rrit rrezikun e keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të sigurojë që vendosen kontrolle të shtuara në menaxhimin e automjeteve zyrtare, me theks të veqantë në arsyeshmërinë e shpenzimeve për veturat private. Duhet të aplikohen aprovimet paraprake për çdo tejkalim të nevojshëm të këtyre limiteve dhe të sigurohen raportime të rregullta të shpenzimeve për secilin automjet zyrtar.

3.7.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 129,473€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. MPMS nuk kishte kontrolle të mjaftueshme në menaxhimin e obligimeve të papaguara pasi që nuk ka aplikuar një proces të mirëfilltë të mbledhjes dhe raportimit të faturave të papaguara.

Çështja 20 - Menaxhim jo-efektiv i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura Nga pagesat e vitit 2015 për faturat e viteve të mëparshme, kemi konfirmuar se Ministria nuk i kishte shpalosur të njëjtat në PVF-të e vitit 2014 si obligime të papaguara në vlerë 30,051€.

Pagesa në vlerë 61,827€ ishin ekzekutuar nga ana e Thesarit si rezultat i mosnjohjes dhe pagesës me kohë të këtyre obligimeve nga ana e Ministrisë.

Rreziku Mungesa e një procesi të mirëfilltë të mbledhjes dhe raportimit të obligimeve mund të shpie në mospagesë të tyre me kohë dhe mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe mospërmbushje të objektivave, pasi pagesa të tjera mund të ekzekutohen nga Thesari në çdo kohë.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të inicojë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, për tu siguruar se do të bëhet vlerësim sistematik i borxheve dhe do të merren masat adekuate për përmirësim të gjendjes aktuale.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
Rekomandimet e vitit paraprak	**Rekomandimi 1** Ministri duhet të sigurojë që një plan i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Rekomandimet që nuk implementohen brenda afateve të pritshme kohore duhet të shqyrtohen formalisht nga Ministri dhe të merren veprime proaktive për ti adresuar arsyet e raportuara për vonesat e implementimit.		Rekomandimi i adresuar por jo i implementuar, pasi qe plani i veprimit me afatet kohore dhe stafin përgjegjës është bërë, mirëpo nuk ishin ndërmarrë masat e duhura për implementimin e të gjitha rekomandimeve dhe veprimet për t'i adresuar arsyet për vonesat e implementimit.	
Qeverisja e mirë	**Rekomandimi 2** Ministri duhet të inicoj një rishikim të kërkesave ekzistuese të raportimit dhe të implementoj aranzhime të përmirësuara për t"i përmbushur nevojat e MPMS-së. Kërkesat të cilat nuk janë zbatuar duhet të implementohen deri në fund të vitit 2015. Cilësia e çështjeve të ndërlidhura, siç është raportimi i brendshëm duhet të rishikohet në mënyrë kritike për të demonstruar një menaxhim efektiv operacional të Ministrisë dhe arritjen e objektivave strategjike		Rekomandimi ishte adresuar, por nuk është implementuar, pasi që ishin ndërmarrë veprime për dërgimin e raporteve tek SP, mirëpo ka vazhduar mangësitë në shqyrtimin formal dhe përmbajtjen e atyre raporteve.	
Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit	**Rekomandimi 3** Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe të identifikohen dhe adresohen barrierat për të planifikuar nivelet e duhura të realizimit të buxhetit. Nëse supozimet e			Rekomandimi nuk është adresuar, pasi dinamika e shpenzimit tek I.K këtë vit ishte e

	buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Donacionet e jashtme duhet të menaxhohen konform kushteve të dakorduara me donatorët për të maksimizuar arkëtimet.			njejtë dhe menaxhimi i donacioneve tregonte mangësitë e njëjta.
Prokurimi Dobësitë sistematike	**Rekomandimi 4** Ministri të sigurojë kryerjen e një rishikimi për të identifikuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar dhe të implementoj kontrolle të përmirësuara për të siguruar se dështimet e tilla nuk do të perseritën.		Është adresuar, por nuk është implementuar plotësisht. Dobësitë e identifikuara në 2014 nuk janë përsëritur, por janë identifikuar dobësi të tjera.	
Prokurimi - Dobësitë jo sistematike	**Rekomandimi 5** Ministri duhet të rishikojë pse praktikat e dobëta të prokurimit janë aplikuar në këto raste dhe të implementoj kontrolle të zgjeruara të cilat sigurojnë që prokurimet reflektojë nevojat reale buxhetore dhe arritjen e kërkesave ligjore përfshirë procesin e aprovimit		Rekomandimi është adresuar, por nuk është implementuar plotësisht. Dobësitë identifikuara në vitin 2014 nuk janë përsëritur, mirëpo janë identifikuar dobësi të tjera.	
Shpenzimet jo përmes prokurimit	**Rekomandimi 6** Ministri në bashkëpunim me Zyrën e Komisioneve mjekësore dhe zyrën ligjore duhet të punoj në hartimin e një politike për përcaktimin e mënyrës së angazhimit si dhe formën dhe lartësinë e kompensimit të mjekëve pjesëmarrës në komisione.	Rekomandimi është implementuar		
Shpenzimet jo përmes prokurimit	**Rekomandimi 7** Ministri duhet të rishikoj kontrollet ekzituese në lidhje me pagesat e avanseve dhe të vendos kontrolle për të siguruar mbylljën e avanceve me kohë të mbështetura me dokumentacionin adekuat për të mbështetur validitetin.			Rekomandimi nuk ishte adresuar. Raste të njejta janë identifikuar edhe gjate vitit 2015.
Shpenzimet jo	**Rekomandimi 8** Ministri duhet të bashkëpunoj me	Rekomandimi i		

përmes prokurimit	MF dhe AKK për të kërkuar një marrëveshje të thjeshtuar për këtë çështje në mënyrë që pagesat të buxhetohen dhe paguhen nga AKK.	implementuar.		
Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	**Rekomandimi 9** Ministri duhet të përcaktoj pse procedurat e kërkuara të avancimit dhe procedurat e kërkuara të rekrutimit nuk janë aplikuar në rastet e identifikuara dhe të rrit kontrollet e brendshme duke siguruar që rregulloret relevante janë respektuar me konsistencë në të gjitha rastet.		Ishte adresuar por nuk ishte implementuar. Nuk kishte parregullsi në gradimet, por kishte mangësi në procedurat e rekrutimit, mosrespektimi i afateve ligjore për UD etj.	
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 10** Ministri duhet të merr këshilla ligjore në aplikimin e UA 01/2014 si bazë për financimin e S&T. Të gjitha pagesat duhet të reflektojnë kritere specifike në përputhje me objektivat e MPMS. Financimi të përjashtohet aty ku përfituesit nuk sigurojnë informatat e kërkuara.	Rekomandimi është implementuar.		
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 11** Ministri duhet të përcaktojë pse buxheti mallra dhe shërbimeve nuk ka qenë i prioritizuar për këtë aktivitet, në veqanti pasi buxheti kishte nënshpenzim në këtë fushë dhe kërkesat e ngjajshme në të ardhmën duhet të përfshihen në kërkesat buxhetore. Duhet të zbatohen kontrolle të përforcuara për të siguruar që vetëm pagesat valide janë bërë, dhe se ato janë mbështetur me informata të nevojshme dhe të mjaftueshme.			Rekomandimi nuk ishte adresuar, pasi që edhe në këtë vit ka raste të keqklasifikimit të shpenzimeve dhe pagesës së shërbimeve nga subvencionet dhe transferet.
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 12** Ministri duhet të përcaktojë pse rregulloret ekzistuese nuk janë aplikuar në rastet e identifikuara si dhe kontrolle shtesë për adresimin e rasteve të identifkuara. Kjo mund të ndërlidhet me aplikimin barazimeve mujore me listat e ofruara nga Organet komunale, institucionet fetare		Rekomandimi është adresuar, por nuk ishte implementuar plotësisht, pasi edhe në vitin 2015 ka numër të konsiderueshëm të rasteve të pagesave të pensioneve për	

	dhe institucionet tjera relevante. Për rastet e identifikuara të pagesave pas vdekjes së përfituesve, duhet të ndërmerren masa për kthimin e shumave të paguara.		personat e vdekur.	
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 13** Ministri duhet të implementojë një rishikim për të siguruar se janë implementuar kontrolle të zgjeruara që sigurojnë që mbështetja e synuar për invalidët e luftës është bazuar në mënyrë efektive në implementimin e MiM.	Rekomandimi ishte mplementuar.		
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 14** Ministri duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar që të gjitha vlerësimet janë kryer brenda kohës së planifikuar. Duhet të shqyrtohen pagesat e bëra pa bazë ligjore dhe duhet ndërmarrë veprime për të parandaluar përsëritjen epageses së tillë.		Është adresuar, por nuk ishte implementuar. Gjatë 2015 nuk kishte raste të mungesës së dokumentacionit adekuat të pensionit nga PPAK, por, kishte pagesa të parregullta.	
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 15** Ministri duhet të përforcojë kontrollet në menaxhimin e skemave sociale. Kjo duhet të përfshijë funksionimin efikas të zingjirit llogaridhënës në ketë fushë, inspektime formale, monitorim të procesit të verifikimit dhe raportime të regullta financiare nga QPS tek drejtori i Departamentit përkatës dhe nga drejtori departamentit tek SP.		Ishte adresuar, por nuk ishte implementuar plotësisht. Nuk kishte raste të mungesës së dokumentacionit adekuat të pensionit nga asistenca sociale, por, kishte pagesa të parregulta të pensioneve nga kjo kategori.	
Subvencionet dhe Transferet	**Rekomandimi 16** Ministri duhet të punoj me Menaxhmentin e Trepçës për të përcaktuar bazën e gabimeve të identifikuara dhe të sigurojë që kontrollet e duhura mbikqyrëse janë aplikuar për të shmangur gabime të ngjajshme në të ardhmën.		Ishte adresuar, por nuk ishte implementuar plotësisht. Gjatë 2015 nuk kishte mungesë të dokumentacionit adekuat të pensioneve të Trepçës, por, kishte disa mangësi të tjera.	
Pasuritë kapitale	**Rekomandimi 17** Ministri duhet të sigurojë që janë	Rekomandimi		

dhe jo-kapitale	implementuar kontrollet për të ofruar siguri që transferi i aseteve zbatohet në baza kohore në linjë me marrëveshjet kontraktuale.	është implementuar.		
Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	**Rekomandimi 18** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e dala nga rregullat për menaxhimin e veturave zyrtare nuk janë aplikuar dhe nëse është i arsyeshëm përdorimi i veturave private. Në bazë të shkaqeve të identifikuara, duhet të sigurohen kontrolle të zgjeruara për të siguruar se shpenzimet e derivateve janë të vlefshme dhe janë paguar vetëm në bazë të përdorimit zyrtar.		Rekomandimi është adresuar pasi që gjatë vitit 2015 nuk kishte vetura që shfrytëzohen 24 ore pa vendime adekuate, mirëpo kishte mangësi në raportimin e vijueshmërisë dhe tejkalimint në aprovimin e shpenzimeve.	
Sistemi i auditimit të brendshëm	**Rekomandimi 19** Ministri duhet të sigurojë që një plan i auditimit gjithëpërfshirës bazuar në vlerësim të rreziqeve është zhvilluar dhe implementuar në plotësi çdo vit për të siguruar sigurinë e kërkuar nga Menaxhmenti. Një rishikim i kontrollit të cilësisë duhet të aplikohet për çdo dosje të auditimit nga Drejtori i NjAB dhe të konfirmohet në raportin vjetor të Komitetit të Auditimit. Menaxhmenti duhet të hartojë një plan të veprimit dhe të monitorojë implementimin e rekomandimeve të NjAB në baza tremujore.	Rekomandimi ishte implementuar.		
4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	**Rekomandimi 20** Ministri duhet të shqyrtojë pavarësinë dhe funksionimin aktual të KA për të siguruar efektivitetin dhe kontributin e tij në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe në sfidimin e aktiviteteve të NjAB sa i përket fushëveprimit dhe cilësisë.		Rekomandimi ishte adresuar por nuk ishte implemtuar, pasi që ishin bërë ndryshime në strukturën e KA, mirëpo nuk ishte rritur cilësia e punës së tij.	